

FILLORISTËT DHE SHMANGIET E NORMAVE DREJTSHKRIMORE**Zymbyle AMETI¹***1* Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova***Corresponding author e-mail: zymbyle.ameti@unite.edu.mk***Përmbledhje**

Në këtë punim synojmë të hulumtojmë se sa fëmijët e shkollave fillore e zotërojnë shqipen standarde, ku i hasin pengesat më të mëdha gjatë përdorimit të saj dhe cilët janë faktorët kryesorë që çojnë deri te pengesat. Punimi ka shtruar hipotezat, argumentet dhe konkluzionet duke u bazuar në të dhënat që janë grumbulluar nga anketa e realizuar me nxënësit e shkollave fillore komunale të qytetit të Gostivarit. Gjatë realizimit të hulumtimit janë përdorur metoda e anketimit të drejtpërdrejtë për të mbledhur të dhëna konkrete nga nxënësit dhe metoda përshkruese për shpjegimin teorik të problemit që hulumtojmë.

Fjalët kyçe: drejtshkrimi, filloristët, gabimet drejtshkrimore etj.

Hyrje

Trashëgimia më e madhe që mund t'ua lëmë breznive është një gjuhë e pastër e pa gabime. Gjuhë e pastër e pa gabime duhet të jetë “formula” që i mësohet çdo fëmije që në vegjëli duke ia treguar hap pas hapi versionin e duhur e të saktë. Historia dëshmon që shqipja është një ndër gjuhët më të lashta ashtu siç populli që e flet atë, andaj meriton të flitet e të shkruhet pa gabime prej secilit që është bartës i saj. Gjuha shqipe dhe të rinjtë ka qenë temë diskutimi e konferencave dhe debateve të ndryshme, andaj s'mund të themi që sjellim risi për nga tema që kemi zgjedhur ta hulumtojmë, por synojmë këtë temë ta plotësojmë me njohuri të reja teorike e praktike. Në gjuhë çdoherë ka një derë e mbyllur që pret të hapet për t'u studiuar. Hulumtimi është bazuar në dy hipoteza:

1. Nxënësit gabojnë më shumë gjatë përdorimit të foljeve.
2. Filloristët nuk përdorin përshëndetje të huaja në të shkruar.

Të dhënat u grumbulluan nga pyetëtori i cili përmbante katër ushtrime për lëmenj të ndryshëm të gjuhës. Në anketim morën pjesë dyqind e katër filloristë (dyzet e katër nga klasa e 6-të, dyzet e tetë nga klasa e 7-të, pesëdhjetë e nëntë nga klasa e 8-të dhe pesëdhjetë e tre nga klasa e 9-të). Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të kuptohen shmangiet më të shpeshta të normës drejtshkrimore si dhe faktorët kryesorë që i nxisin ato. Duke pasur për objekt studimi vetë nxënësit identifikimi i gabimeve dhe faktorëve synojmë të jetë më i lehtë dhe sugjerimet për zgjidhje të problemit të jenë më praktike.

1. Pasqyrimi i rezultateve

Për të parë sa filloristët janë të afërt me normat e drejtshkrimit atyre u dhamë ushtrime të ndryshme edhe atë: fjalë që duhej t'i shkruanin saktë duke u bazuar në rregullën e përdorimit të shkronjës së madhe, fjalë që duhej t'i rrethonin në janë shkruar mirë apo gabim, të shkruanin format e përhëndetjeve për kohë të ndryshme si dhe të bënim një përshtkrim të shkurtër të stinës së pranverës (dy-tri fjali). Rezultatet dëshmojnë që vetëm një numër i vogël i nxënësve i zotëron e zbaton normat drejtshkrimore dhe se ka shumë nga ta që përzgjedhën trajtën jonormative si përgjigje të saktë ose zgjedhën të mos përgjigjen.

Më poshtë do t'i trajtojmë përgjigjet që morëm për çdo ushtrim të parashtruar. E kemi të njohur që shkronja e madhe përdoret për të veçuar emrat e përveçëm dhe emërtimet e barasvlershme me to nga emrat e përgjithshëm. Këtë rregull e kishin të njohur edhe nxënësit dhe këtë e kuptuam nga bisedat e lira që realizuam me ta në lidhje me gjuhën shqipe. Por, për të parë se sa kjo njohuri vihet në praktikë u kërkua nga të anketuarit t'i shkruajnë sipas normës fjalët: Viti i Ri, shqiptarët, Jeronim de Rada, Presidenti i Republikës së Shqipërisë si dhe të rrethojnë në janë shkruar mirë apo gabim shkurtesat: OKB, NATO, SHBA, FIFA, SHFK.

Në vijim do të paraqesim rezultatet që morëm:
-për shkrimin e saktë të fjalës Viti i Ri u dhanë përgjigjet:

Tabela 1: Përgjigjet e dhëna nga nxënësit për fjalën Viti i Ri.

Përgjigjet	Nr.	%
Viti i Ri	68	33.4
Viti I Ri	37	18.1
Viti i ri	82	40.2
Viti I ri	10	4.9
viti i ri	7	3.4
Total	204	100.0

Në bazë të Drejtshkrimit shkruhen me shkronjë të madhe pjesët përbërëse të emërtimeve të festave kombëtare e ndërkombëtare, si: Dita e Mësuesit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, andaj edhe Viti i Ri. Përgjigje të saktë kanë dhënë 33,4% e nxënësve.

-për fjalën shqiptarët përgjigjet e filloristëve janë si më poshtë:

Tabela 2: Përgjigjet e dhëna nga nxënësit për fjalën Shqiptarët

Përgjigjet	Nr.	%
Shqiptarët	77	37.7
Shqiptarët	127	62.3
Total	204	100.0

Në gjuhën shqipe emrat e popujve dhe të banorëve të një vendi, të një krahine, të një qyteti, kontinenti etj. shkruhen me shkronjë të vogël: francezët, evropianët, gostivarasit, andaj edhe shqiptarët. Për këtë fjalë numri më i madh i nxënësve kanë dhënë përgjigje të gabuar (62,3%) duke e shënuar emërtimin me shkronjë të madhe.

-për emrin Jeronim de Rada përgjigjet e të anketuarve janë:

Tabela 3: Përgjigjet e dhëna nga nxënësit për emrin Jeronim de Rada.

Përgjigjet	Nr.	%
Jeronim De Rada	56	27.4
Jeronim de Rada	87	42.6
Jeronim de rada	33	16.2
jeronim de rada	14	6.9
Jeronim De rada	4	2.0
jeronim De Rada	10	4.9
Total	204	100.0

Sipas *Drejtshkrimit të shqipes* nyjat dhe pjesëzat e mbiemrave shkruhen me shkronjë të vogël, kur jepet i plotë emri dhe mbiemri i personit, por shkruhen me shkronjë të madhe, kur përdoret vetëm mbiemri dhe kur nyja ose pjesëza është element i domosdoshëm i tij: Leonardo da Vinçi, por Da Vinçi, Vincent van Gog, por Van Gog, andaj Jeronim de Rada, por De Rada. Siç edhe shihet në tabelë janë përgjigjur saktë 42,6% e nxënësve.

-për emërtimin Presidenti i Republikës së Shqipërisë rezultatet e fituara janë:

Tabela 4: Përgjigjet e nxënësve për emërtimin presidenti i Republikës së shqipërisë

Përgjigjet	Nr.	%
Valid Presidenti i Republikës së Shqipërisë	80	39.2
presidenti i Republikës së Shqipërisë	70	34.3
presidenti i republikës së Shqipërisë	34	16.7
Presidenti i republikës së Shqipërisë	20	9.8
Total	204	100.0

Për emërtimet e funksioneve shtetërore, ushtarake, politike, të gradave etj. në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* ka laramani për normën se si duhet shkruar, andaj gjuhëtarë të ndryshëm në *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)* I janë shprehur se duhet bërë ndryshime për të ardhur deri në një normë për të gjitha rastet. Disa nga studiuesit janë të mendimit që për të gjitha këto forma shkrimi të ndiqet një kriter i vetëm dhe këta emra të shkruhen me shkronjë të vogël, si: presidenti i Republikës së Shqipërisë, anëtari i Akademisë së Shkencave etj., ndërsa të tjerë mendojnë se emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore më të larta në Shqipëri, Kosovë e analogjikisht edhe në vende të tjera duhet të shkruhen me shkronjë të madhe, p.sh.: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri i Kosovës etj.

Përfundim nga kjo rregull sipas tyre bëjnë emërtimet e larta si ministër, rektor etj. sepse ministra, rektorë ka shumë, prandaj shkruhet me shkronjë të madhe vetëm emërtimi i dikasterit. Por, meqenëse ende s'është caktuar një normë e re për këto emërtime ne kemi marrë si të saktë përgjigjen që i referohet rregullës §74 të *Drejtshkrimit* (1972) sipas së cilës: “emërtimet e funksioneve zyrtare e shoqërore më të larta shkruhen me shkronjë të madhe (të gjitha fjalët që hyjnë në përbërjen e tyre, me përjashtim të nyjave)”, andaj konstatohet se përgjigje të saktë për këtë emërtim kanë dhënë 39.2% e nxënësve. Duke vërejtur rezultatet në katër tabelat e mësipërme arrijmë në përfundimin se mesatarisht filloristët janë në gjendje të përdorin drejt shkronjën e madhe. Sa i përket shkurtesave siç shihet dhe më poshtë 93,6 % e nxënësve kanë dhënë përgjigje të saktë.

Tabela 5: Përgjigjet për shkurtesat e emërtimeve: OKB, NATO, SHBA, FIFA, SHFK

Përgjigjet	Nr.	%
a) saktë	191	93.6
b) gabim	13	6.4
Total	204	100.0

Për të parë njohuritë e nxënësve rreth normave të drejtshkrimit, një ndër detyrat e parashtruara ishte edhe të analizonin a janë shkruar saktë fjalët: egzistencë, njëjtë, musliman, shndërrim, apsolvent, azgjë dhe bufe. Në vazhdim do t'i shqyrtojmë përgjigjet. Sipas §3 të *Drejtshkrimit*: “shkruhen me ë të gjitha fjalët të cilat kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një a-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore. Me ë shkruhen edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra, të formuara prej tyre pavarësisht nga lëvizja e theksit”, si: këmbësor, nxënës, lëndë, këngë etj., andaj edhe (i,e) njëjtë. Të këtij mendimi kanë qenë 41,2% e filloristëve (tetëdhjetë e katër nxënës).

Shkruhen me u dhe jo me y fjalët: bulmet, kurbet, sfungjer, tunel, etj. Në këtë grup bën pjesë edhe fjala bufe. Kanë qenë të mendimit të drejtë se shkruhet me u fjala bufe 46,5 % e nxënësve (nëntëdhjetë e tre nxënës). Ndërsa, për dallim nga fjalët e mësipërme shkruhen me y dhe jo me u fjalët: mysafir, byrek, byro, etj. Shkruhet me y edhe fjala mysliman. S'e kanë shkelur normën drejtshkrimore duke rrethuar “jo” vetëm 22,1% e filloristëve (dyzet e pesë nxënës).

Ka raste kur bashkëtingëlloret prapagjuhore [k, g] ia zënë vendin njëra-tjetrës, duke i shqiptuar e shkruar fjalët në mënyrë të gabuar, si për shembull shkruhen e shqiptohen me [g] fjalët: guzhinë, egzistoj, gabinë etj, për: kuzhinë, ekzistoj, kabinë. Se përdoren shpesh në formë të gabuar është vërtetuar edhe nga përgjigjet e grumbulluara, për fjalën *egzistencë, vetëm 18,1% e nxënësve (tridhjetë e shtatë nxënës) e kanë rrethuar opsionin e saktë.

Shmangie të normës ndodh edhe me përdorimin e bashkëtingëlloreve buzore [b, p] si: apsolvent për absolvent ashtu edhe për bashkëtingëlloret paragjuhore [s, z], si: azgjë për asgjë. Përgjigje të saktë për fjalën *azgjë kanë dhënë 16,7% e nxënësve (tridhjetë e katër nxënës), ndërsa për fjalën *apsolvent 43,6% e tyre (tetëdhjetë e nëntë nxënës). Një nga fjalët që ka marrë më pak përgjigje të sakta është fjala shndërrim. Për të janë përgjigjur në mënyrë të drejtë 24,5% e të anketuarve (pesëdhjetë anketues). Jemi të mendimit se një ndër shkaqet kryesore në përqindjen e madhe të përgjigjeve të pasakta për këtë fjalë e edhe e fjalëve të lartpërmendura është fakti se shumica e tyre shkruhen shpesh në formë të gabuar edhe në: revista, gazeta etj.

Shpresojmë që në të ardhmen kësaj gabimesh të bëhen më pak si në të folur e edhe në të shkruar sepse vetëm në atë mënyrë mund t'i marrim përgjigjet e sakta e të hasim më pak gabime në të shkruarit e shkollarëve.

1.1. Si përshëndesin të rinjtë?

Nga *Gramatika e gjuhës shqipe I* dihet se në grupin e pasthirmave bëjnë pjesë edhe përshëndetjet, si fjalët: lamtumirë, mirupafshim, mirë mbeç etj. Përfshirja e tyre në hulumtimin tonë kishte dy qëllime kryesore:

-të kuptohet cilat janë përshëndetjet më të shpeshta që të rinjtë i përdorin

-të analizohet a bëjnë shmangie të normës gjatë shkrimit të përshëndetjeve të rinjtë.

Qëllimet u realizuan sepse morëm përgjigje për të dyja pyetjet e mësipërme. Për t'i marrë përgjigjet e duhura u kërkuan nxënësve të shkruajnë si përshëndeten ata me të tjerët: kur takohen në mbrëmje, kur takohen ditën dhe kur ndahen në mëngjes.

Përgjigjet e fituara janë si më poshtë:

Tabela 6: Si përshëndetin të anketuarit kur takohen në mbrëmje

Përgjigjet	Nr.	%
mirë mbrëma	80	39.2
Mirëmbërëma	42	20.6
mirëmbërëma!	8	3.9
Mirmbrëma	43	21.1
Mirmroma	6	2.9
mir mbrëma	15	7.4
Mirmbrëmje	6	2.9
Mirbrëma	4	2.0
Total	204	100.0

Po të ndalemi të analizojmë tabelën e mësipërme shohim se për qëllimin e parë (të përmendur në fillim) do të jepej përgjigja **mirëmbërëma** sepse është përshëndetja që ka grumbulluar më shumë përqindje, ndërsa për qëllimin e dytë përgjigja “po” sepse vetëm 24,5% e tyre (20,6% mirëmbërëma dhe 3,9% mirëmbërëma!) e kanë shkruar sipas normave të *Drejtshkrimit të shqipes*.

Tabela 7: Si përshëndetin të anketuarit kur takohen ditën

Përgjigjet	Nr.	%
Mirëdita	56	27.4
mirëdita!	16	7.8
Mirdita	76	37.3
Hello	14	6.9
Përshëndetje	8	3.9
mir dita	12	5.9
mirë dita	22	10.8
Total	204	100.0

Në tabelën nr. 7 shohim që shkollarët kur takohen me të tjerët gjatë ditës i përshëndetin me shprehjen mirëdita, pasi ajo është shprehja që kanë përzgjedhur ta shkruajnë 37,3% e të anketuarve që njëherësh është shkruar jashtë normës drejtshkrimore: *mirdita. Kur vëzhgojmë po të njëjtën tabelë na bie në sy edhe një shprehje tjetër e cila ka grumbulluar 6,9% (14 nxënës), përshëndetja hello. Prezencën e kësaj shprehjeje në tabelë s'e potencuam se jemi të habitur që është dhënë si përgjigje, por se jemi të mendimit që kjo shprehje jo vetëm që përdoret nga të rinjtë, por edhe përdoret me denduri më të madhe në ligjërimin e folur e të shkruar shoqëror.

Sa i përket përshëndetjes kur ndahen në mëngjes, shkollarët preferojnë të përdorin shprehjen: ditën e mirë, këtë pohim e dëshmojnë përgjigjet në tabelën e mëposhtme. Vlen të theksohet se kjo përshëndetje është shkruar sipas normës drejtshkrimore të shkrimit të saj.

Tabela 8: Si përshëndetin të anketuarit kur ndahen në mëngjes

Përgjigjet	Nr.	%
Mirupafshim	10	4.7
ditën e mirë!	2	1.0
ditën e mire	50	24.5
mir u pafshim	8	3.9
kalofsh bukur	5	2.5
ditën e mir	41	20.1
Mirmëngjesi	32	15.7
mir mëngjesi	14	6.9
Ditënemirë	14	6.9
Mirëupafshim	11	5.4
kalofsh mirë	2	1.0
mirupafshim!	5	2.5
mëngjesin e mir	10	4.9
Total	204	100.0

Bazuar në rezultat e përgjithshme të fituara mund të konstatojmë se te filloristët hasen pësjtjellime të shumta edhe në shkrimin e përshëndetjeve.

1.2. Gabimet drejtshkrimore e gramatikore të bëra nga të anketuarit gjatë përshkrimit të stinës së pranverës

Se filloristët kanë probleme me përdorimin e drejtë të shqipes është vërejtur gjatë shqyrtimit të çdo pyetjeje të anketimit, por ky problem del në pah më dukshëm në pyetjen e fundit në të cilën kërkohet ta përshkruanin stinën e pranverës me dy-tri fjali. Shkelja e normave drejtshkrimore e gramatikore është bërë në mënyra të ndryshme edhe atë: mospërdorimi i trajtave normative për shumësin e emrave, përdorimi i emrave në rasë e trajtë të gabuar, përdorimi i fjalëve në të folurën krahinore, mospërdorimi i fonemës [ë] në asnjë pozicion dhe zëvendësimi i saj me fonemën [e], mosvendosja e shenjave të pikësimit, fillimi i fjalisë me shkronjë të vogël, përdorimi i gabuar i shkronjës së madhe, përdorimi i foljes në vetë dhe kohë të gabuar, mospërdorimi i parafjalëve e lidhëzave të duhura, të shprehurit me fjalë të huaja, të kuptuarit e fjalive si fjalë dhe radhitja e dy-tri të tillave, përdorimi i gabuar i nyjës së përparme

te mbiemrat, radhitja e gabuar e fjalëve në fjali, mospërdorimi i duhur i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë etj.

Më poshtë do të shënojmë disa nga shembujt e fjalive në të cilat është bërë shkelje e normës drejtshkrimore e gramatikore:

*Ne pranver esht mir se sesht shum nxefet.

*Fëmijët dalin luajn me shokët.

*Zogët cicërojn.

*Na vin zogjtë të bukur.

*Në stinën e pranverës del pakë djellë.

*S’kina cold.

Për:

•Në pranverë është mirë se s’është shumë nxehtë.

•Fëmijët dalin të luajnë me shokët.

•Zogjtë cicëronjë.

•Na vijnë zogjtë e bukur.

•Në stinën e pranverës del pak diell.

•S’kemi ftohtë.

Përfundim

Sa i përket hulumtimit të realizuar, nga të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet e analizuara mund të përfundojmë se në përgjithësi filloristët nuk i njohin aq sa duhet rregullat drejtshkrimore e gramatikore. Për hipotezat e dhëna në fillim të hulumtimit mund të themi se hipoteza e parë vërtetohet sepse gjatë analizimit të të dhënave vërejtëm shumë gabime në përdorimin e foljeve (sidomos në përshtatjen e tyre në kohë e vetë), ndërsa hipoteza e dytë bie sepse u vërtetua se shkollarët përdorin fjalë e shprehje të huaja edhe në të shkruar.

Referencat

- [1]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (1978). *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- [2]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë.
- [3]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë.
- [4]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.
- [5]. Demiraj, Sh. (2013) *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë: Onufri.
- [6]. Dhrimo, A, Memushaj, R. (2015). *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Infbotues.
- [7]. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. (2022). *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. V. I-II. Shkup.
- [8]. Memushaj, R. (2012). *Për shqipen standarde I*. Tiranë: Infbotues.
- [9]. Memushaj, R. (2005). *Shqipja standarde*. Tiranë: Toena.
- [10]. Munishi, Z. (2013). *Zgjedhimi i foljeve*. Tiranë: Artini.
- [11]. Sinani, I. (2022). *Gjuha shqipe në tekstet shkollore*. *Albanologjia*. vëllimi IX, nr. 17-18, f. 134-139. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- [12]. Sulejmani, B. (2011). *Gjuha standarde shqipe dhe shkolla*. Shkup: Logos-A.